4Z1. Bazat e statistikës	E	3	30
4Z2. Gjuhë Angleze 4	E	3	30
4Z3. Teknikat e interaksionit	E	3	30
4Z4. Krijimi i dokumenteve teknike	E	3	30
Total ECTS		60	

Përfshin 8 lëndë obligative dhe 4 prej 9 lëndëve zgjedhore

Viti III - Semestri V dhe VI

Lënda	Statusi	ECTS	Orë
5O1. Bazat e të dhënave	O	6	60
5O2. Siguria në rrjetat e TI-ve	O	6	60
5O3. Konvergjenca në rrjeta	O	6	60
5O4. Veglat për siguri në internet	O	6	60
5Z1. Menaxhimi i kualitetit	E	3	30
5Z2. Përmbajtja statike e Web-ingjineriut	E	3	30
5Z3. Menaxhimi i informacionit	E	3	30
5Z4. Investimet dhe Financimet	E	3	30
6O1. Përmbajtja dinamike e Web-ingjineriut	O	6	60
6O2. Koncepte të telekomunikimit mobil	O	6	60
6O3. Tema e diplomës / Projekti final	O	12	
6Z1. Menaxhimi i shërbimit të TI-ve	E	3	30
6Z2. Menaxhimi i sigurisë në internet	E	3	30
6Z3. Kontrolla	E	3	30
Total ECTS		60	

Përfshin 6 lëndë obligative temën e diplomës / projektin final dhe 4 prej 7 lëndëve zgjedhore

IV. FAKULTETI I EDUKIMIT

Drejtimit:

4.1. Programi Parashkollor

4.2. Programi Fillor

4.3. Gjuhë Gjermane

4.1. Programi Parashkollor

Ekzistimi dhe funksionimi i këtij programi bazohet në këto arsye:

- Hapja ndaj universiteteve evropiane dhe kyçja në rrjedhat bashkëkohore të reformave arsimore të arsimit të lartë Evropian.
- Kërkimet shkencore dhe përvoja nga praktika tregojnë se formimi i mësimdhënësve të Arsimit parashkollor duhet të bëhet në nivel të arsimit universitar, gjë që shihet në programet e ngjashme të vendeve të Evropës, në Ligjin për Arsimin e lartë si edhe në Strategjinë e arsimit të lartë të Kosovës.
- Nevoja e studentëve-mësimdhënës të ardhshëm të Arsimit parashkollor për të arritur kompetenca profesionale në përputhshmëri me kompetencat të cilat arrihen në fakultetet përkatëse të Evropës, duke respektuar veçoritë specifike të traditës Kosovare në formimin e mësimdhënësve të parafillores.
- Përgatitja e mësimdhënësve të ardhshëm të parafillorës e bazuar në njohuri shkencore, përvoja pedagogjike dhe në metodologjitë inovative – duke bërë përparim të dukshëm në promovimin e arsimit .
- Duke pasur parasysh se ndryshimi i kurrikulës është në proces e sipër, dhe edhe pse është bërë një përparim i mirë prej vitit 2002, kjo nuk është e mjaftueshme, dhe si e tillë mbetet një objektivat e punës i këtij programi.
- Mësimdhënësit janë agjentët kryesorë sa i përket implementimit të kurrikulës nëpër institucionet shkollore dhe roli i tyre paraqet një sfidë të vërtetë në organizimin e aktiviteteve mësimore nga fusha e mësimdhënësit parafillor.
- Fakulteti i Edukimit si institucion i cili përgatit mësimdhënës për tri nivelet e para të arsimit, dhe si institucion i cili vazhdon traditën e ish SHLP të Kosovës, disponon me kapacitetin kadrovik dhe plotëson kushtet e nevojshme për formimin e mësimdhënësve të programit parafillor.

Analiza e programit të studimit

Me qëllim të përfshirjes së rezultateve të hulumtimeve shkencore nga fusha e arsimit parafillor, por edhe me qëllim të arritjes së rezultateve gjithnjë e më të mira në përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm të programit parafillor (parshkollore), analiza e programit të studimit është një proces i rishikimit të vazhdueshëm.

Në përpilimin e programit të studimit për mësimdhënës të ardhshëm jemi udhëhequr nga pyetja: Çfarë njohuri dhe aftësi u nevojiten mësimdhënësve për parafillorë?

Duke dashur të përgjigjemi në këtë pyetje, duke u konsultuar me programet e ngjashme të Universiteteve tjera, kemi parë se programi i studimeve katërvjeçare për mësimdhënës njëlëndor të programit parafillor (parshkollor) duhet të përbëhet prej tri segmenteve:

Arsimimi në kompetencat e programit fillor që nënkupton njohja dhe të kuptuarit e rezultateve kryesore nga fushat kryesore të fillores, njohurive themelore nga parafillori dhe aftësimi në zgjidhjen kreative të problemeve duke shfrytëzuar teknologjinë informatike (TI).

Arsimimi në kompetencat profesionale, didaktike, pedagogjike dhe psikologjike për realizim të suksesshëm të programit nga fusha e programit parafillor në parashkollor. Këtu hynë aftësimi i mësimdhënësve të ardhshëm për organizimin e aktiviteteve në forma të ndryshme mësimore, aktivitete praktike, zgjidhje të problemeve, aktiviteteve heuristike, mentorike, e deri te format bashkëkohore të mësimi problemor dhe projektues, zbatim të teknologjisë informatike etj..

Realizimi i mësimi praktik në institucionet e Arsimit parafillor mundëson arritjet e kompetencave të përgjithshme arsimore siç janë në organizimin e procesit mësimor të mësimdhënësit (kujdestaria, udhëheqja e ditareve të punës, dhe dokumentacionit tjetër pedagogjik, bashkëpunimi me prindër, me shërbimet tjera profesionale, etj.)

Kjo arrihet me anët të realizimit të procesit mësimor nga lëndët obligative (të përgjithshme dhe profesionale), lëndët zgjedhore dhe praktikat profesionale në institucionet shkollore të Arsimit parafillor.

Jemi të bindur se ky plan mësimor i programit parafillor do të mundësojë aftësimin e studentëve në realizimin e aktiviteteve nga fushat e njohurive të përcaktuara me kurrikulumin e Arsimit fillorë.

Tregu i punës

Fakulteti i Edukimit është i vetmi institucion i cili përgatit mësimdhënës për shkollat e mesme të ulëta, fillor dhe parafillor të Kosovës, prandaj pas kryerjes së studimeve në programin fillor, studentët e diplomuar përgatiten teorikisht dhe praktikisht për mësimdhënës në parashkollor, në sistemin arsimor të Kosovës dhe jashtë saj.

Po ashtu këta studentë të diplomuar në këtë program mund të vazhdojnë edhe studimet master në fushën e arsimit të përgjithshëm.

Nevojat e parashkollorëve për mësimdhënës deri në ditët e sotme (sipas statistikave nga MASHT) ende nuk janë të plotësuara, prandaj edhe nevoja e funksionimit të këtij programi është e domosdoshme.

Duke marrë parasysh edhe faktin se ekziston një numër i madh i mësimdhënësve të cilët përfundojnë karrierën e tyre si mësimdhënës të programit parafillor në parashkollor, nevoja për përtëritjen e kuadrit të këtillë është e evidente.

PLANI I STUDIMEVE TË PROGRAMIT PARASHKOLLOR

Viti i Parë - Programi Parashkollor				
Semestri I				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 0101	O	GJUHË SHQIPE I	3+2	7
Edu 0102	O	MATEMATIKË I	3+2	7
Edu 0103	O	GJUHË ANGLEZE I	2+2	6
Edu 0104	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	2+1	5
Edu 0105	O	SHKATHËSITË E MËSIMIT AKADEMIK	2+1	5
Semestri II				
Edu 0106	O	GJUHË SHQIPE II	3+2	6
Edu 0107	O	MATEMATIKË II	3+2	6
Edu 0108	O	TIK NE EDUKIMIN PARASHKOLLOR	3+2	6
Edu 0109	O	BAZAT E ARSIMIT MUZIKOR ME METODOLOGJI	3+1	5
Edu 0110	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I (3 JAVE)	/	2
Edu 0111	Z	GJUHË ANGLEZE II	2+1	5
Edu 0112	Z	HISTORIA E ARSIMIT KOMBËTAR	2+1	5
Edu 0113	Z	EDUKATË QYTETARE	2+1	5
Edu 0115	Z	KOMUNIKIMI NE EDUKIM	2+1	5
Edu 0116	Z	LOJRAT SKENIKE NE TE MESUARIT E GJUHES SHQIPE	2+1	5
Edu 0117	Z	LOJRAT GJUHESORE NE TE MESUARIT E GJUHES SHQIPE	2+1	5

*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).

Viti i dytë - Programi Parashkollor				
Semestri III				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 0118	O	LETËRSI FËMIJË	3+2	7
Edu 0119	O	PEDAGOGJI E EDUKIMIT PARASHKOLLOR	3+1	6
Edu 0120	O	HYRJE NE PSIKOLOGJI	3+2	7
Edu 0122	Z	INTERPRETIMI ME INSTRUMENTE MUZIKORE	2+1	5
Edu 0123	Z	SHKATHHTESITE E KOMUNIKIMIT ME FEMIJEN	2+1	5
Edu 0123	Z	ARSIMIMI GJATË GJITHË JETËS	2+1	5
Edu 0125	Z	EDUKATË SHËNDETËSORE	2+1	5
Edu 0126	Z	VIZATIM	2+1	5
*Studenti zgjedh dy (2) kurse nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				
Semestri IV				
Edu 0127	O	BAZAT E SHKENCAVE SHOQËRORE ME METODOLOGJI	3+2	7
Edu 0128	O	BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE ME METODOLOGJI I	3+2	7
Edu 0129	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II (5 JAVE)	/	6
Edu 0130	O	METODOLOGJI E NJOHJES SE KONCEPTEVE MATEMATIKORE	2+1	5
Edu 0131	Z	ARTET E BUKURA	2+1	5
Edu 0132	Z	LOJËRA MUZIKORE TRADICIONALE	2+1	5
Edu 0133	Z	PSIKOLOGJI E ZHVILLIMIT DHE E PERSONALITETIT	2+1	5
Edu 0134	Z	PSIKOLOGJI E LOJES	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				

Viti i tretë - Programi Parashkollor				
Semestri V				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 0135	O	BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE ME METODOLOGJI II	3+2	6
Edu 0136	O	METODOLOGJI E EDUKIMITGJITHEPERFSHIRE	2+2	7
Edu 0137	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE (6 JAVE)		6
Edu 0138	O	METODOLOGJI E GJUHËS SHQIPE	3+1	6
Edu 0139	Z	FAMILJA DHE EDUKIMI PARASHKOLLOR	2+1	5
Edu 0141	Z	LOJRA DHE LODRA	2+1	5
Edu 0142	Z	PSIKOLOGJI EDUKIMI	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				
Semestri VI				
Edu 0143	O	METODOLOGJI E ARTEVE FIGURATIVE	3+1	6
Edu 0144	O	PUNË DORE ME MODELIM	3+2	6
Edu 0145	O	HISTORI KOMBETARE	2+2	5
Edu 0146	O	EDUKIMI MJEDISOR	2+1	5
Edu 0147	Z	ZHVILLIMI I KURRIKULAVE	2+1	4
Edu 0148	Z	PUNA ME FËMIJË TË TALENTUAR	2+1	4
Edu 0149	Z	EDUKATE ESTETIKE	2+1	4
Edu 0150	Z	METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR	2+1	4
Edu 0151	Z	EDUKIMI DHE MEDIAT	2+1	4
*Studenti zgjedh një dy (dy) kurse zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				

Viti i katërt - Programi Parashkollor				
Semestri VII				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 0152	O	DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA	3+2	7
Edu 0153	O	LOJRAT MATEMATIKORE	2+2	5
Edu 0144	O	METODOLOGJI E EDUKIMIT FIZIK	3+2	6
Edu 0155	O	STRATEGJITE E EDUKIMIT PARASHKOLLOR	2+1	5
Edu 0156	Z	ETNOLOGJI ME LETERSI POPULLORE	2+1	5
Edu 0157	Z	VËSHTIRSITE NE TE NXENIT	2+1	5
Edu 0158	Z	TENDENCAT BASHKEKOHORE NE ARSIM	2+1	5
Edu 0159	Z	STRATEGJITE DHE METODAT E SHKRIM LEXIMIT	2+1	5
Edu 0160	Z	VLERËSIMI NE FEMIJERINE E HERSHME	2+1	5
Edu 0161	Z	FEMIJET DHE MESIMI NE NATYRE	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				
Semestri VIII				
Edu 0162	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2+2	6
Edu 0163	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV(8 JAVE)	/	14
Edu 0164	O	PUNIMII DIPLOMES	/	10

4.2. Programi Fillor

Ekzistimi dhe funksionimi i këtij programi bazohet në këto arsye:

- Hapja ndaj universiteteve evropiane dhe kyçja në rrjedhat bashkëkohore të reformave arsimore të arsimit të lartë Evropian.
- Kërkimet shkencore dhe përvoja nga praktika tregojnë se formimi i mësimdhënësve të Arsimit fillorë duhet të bëhet në nivel të arsimit universitar, gjë që shihet në programet e ngjashme të vendeve të Evropës, në Ligjin për Arsimin e lartë si edhe në Strategjinë e arsimit të lartë të Kosovës.
- Nevoja e studentëve-mësimdhënës të ardhshëm të Arsimit fillor për të arritur kompetenca profesionale në përputhshmëri me kompetencat të cilat arrihen në fakultetet përkatëse të Evropës, duke respektuar veçoritë specifike të traditës Kosovare në formimin e mësimdhënësve të fillores.
- Përgatitja e mësimdhënësve të ardhshëm të fillores e bazuar në njohuri shkencore, përvoja pedagogjike dhe në metodologjitë inovative – duke bërë përparim të dukshëm në promovimin e arsimit .
- Duke pasur parasysh se ndryshimi i kurrikulës është në proces e sipër, dhe edhe pse është bërë një përparim i mirë prej vitit 2002, kjo nuk është e mjaftueshme, dhe si e tillë mbetet një objektivat e punës i këtij programi.
- Mësimdhënësit janë agjentët kryesorë sa i përket implementimit të kurrikulës nëpër institucionet shkollore dhe roli i tyre paraqet një sfidë të vërtetë në organizimin e aktiviteteve mësimore nga fusha e mësimdhënësve fillor.
- Fakulteti i Edukimit si institucion i cili përgatit mësimdhënës për tri nivelet e para të arsimit, dhe si institucion i cili vazhdon traditën e ish SHLP të Kosovës, disponon me kapacitetin kadrovik dhe plotëson kushtet e nevojshme për formimin e mësimdhënësve të programit fillor.

Analiza e programit të studimit

Me qëllim të përfshirjes së rezultateve të hulumtimeve shkencore nga fusha e arsimit fillor, por edhe me qëllim të arritjes së rezultateve gjithnjë e më të mira në përgatitjen e mësimdhënësve të ardhshëm të programit fillorë (klasa I-V), analiza e programit të studimit është një proces i rishikimit të vazhdueshëm.

Në përpilimin e programit të studimit për mësimdhënës të ardhshëm jemi udhëhequr nga pyetja: Çfarë njohuri dhe aftësi u nevojiten mësimdhënësve për fillorë?

Duke dashur të përgjigjemi në këtë pyetje, duke u konsultuar me programet e ngjashme të Universiteteve tjera, kemi parë se programi i studimeve katërvjeçare për mësimdhënës njëlëndor të programit fillor (klasa I-v) duhet të përbëhet prej tri segmenteve:

- *Arsimimi në kompetencat e programit fillor* që nënkupton njohja dhe të kuptuarit e rezultateve kryesore nga fushat kryesore të fillores, njohurive themelore nga fillori dhe aftësimi në zgjidhjen kreative të problemeve duke shfrytëzuar teknologjinë informatike (TI).
- *Arsimimi në kompetencat profesionale, didaktike, pedagogjike dhe psikologjike* për realizim të suksesshëm të programit nga fusha e programit fillor në shkollën fillor. Këtu hynë aftësimi i mësimdhënësve të ardhshëm për organizimin e aktiviteteve në forma të ndryshme mësimore, aktivitete praktike, zgjidhje të problemeve, aktiviteteve heuristike, mentorike, e deri te format bashkëkohore të mësimit problemor dhe projektues, zbatim të teknologjisë informatike etj.
- *Realizimi i mësimit praktik në institucionet e Arsimit fillorë* mundëson arritjet e kompetencave të përgjithshme arsimore siq janë në organizimin e procesit mësimor të mësimdhënësit (kujdestaria, udhëheqja e ditarëve të punës, dhe dokumentacionit tjetër pedagogjik, bashkëpunimi me prindër, me shërbimet tjera profesionale etj.)

Kjo arrihet me anët të realizimit të procesit mësimor nga lëndët obligative (të përgjithshme dhe profesionale), lëndët zgjedhore dhe praktikat profesionale në institucionet shkollore të Arsimit fillor.

Jemi të bindur se ky plan mësimor i programit fillor do të mundësojë aftësimin e studentëve në realizimin e aktiviteteve nga fushat e njohurive të përcaktuara me kurrikulumin e Arsimit fillorë.

Tregu i punës

Fakulteti i Edukimit është i vetmi institucion i cili përgatit mësime për shkollat e mesme të ulëta, fillor dhe parafillor të Kosovës, prandaj pas kryerjes së studimeve në programin fillorë, studentët e diplomuar përgatiten teorikisht dhe praktikisht për mësime në shkollat fillorta (klasa I-V), në sistemin arsimor të Kosovës dhe jashtë saj.

Po ashtu këta studentë të diplomuar në këtë program mund të vazhdojnë edhe studimet master në fushën e arsimit të përgjithshëm.

Nevojat e shkollave fillor për mësime deri në ditët e sotme (sipas statistikave nga MASHTK) ende nuk janë të plotësuara, prandaj edhe nevoja e funksionimit të këtij programi është e domosdoshme.

Duke marrë parasysh edhe faktin se ekziston një numër i madh i mësimeve të cilët përfundojnë karrierën e tyre si mësime të programit fillor në shkollën fillorë, nevoja për përtëritjen e kuadrit të këtyre është e evidente.

PLANI I STUDIMEVE

Viti i Parë - Programi Fillor				
Semestri I				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 101	O	GJUHË SHQIPE I	3+2	7
Edu 102	O	MATEMATIKË I	3+2	7
Edu 103	O	GJUHË ANGLEZE I	2+2	6
Edu 104	O	FILOZOFI E EDUKIMIT	2+1	5
Edu 105	O	SHKATHTËSIT E MËSIMIT AKADEMIK	2+1	5
Semestri II				
Edu 106	O	GJUHË SHQIPE II	3+2	6
Edu 107	O	MATEMATIKË II	3+2	6
Edu 108	O	TIK NE EDUKIMIN FILLOR	3+2	6
Edu 109	O	BAZAT E ARSIMIT MUZIKOR ME METODOLOGJI	3+1	5
Edu 110	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE I	/	2
Edu 111	Z	KOMUNIKIMI NE ARSIM	2+1	5
Edu 112	Z	HISTORIA E ARSIMIT KOMBETAR	2+1	5
Edu 113	Z	VIZATIM	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				

Viti i dytë - Programi Fillor				
Semestri III				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 114	O	GJUHË SHQIPE III	3+2	6
Edu 115	O	HYRJE NE PSIKOLOGJI	3+2	6
Edu 116	O	TEORI E MËSIMIT	2+2	5
Edu 117	O	GJUHË ANGLEZE II	2+1	5
Edu 118	Z	INTERPRETIM ME INSTRUMENTE	2+1	4
Edu 119	Z	EDUKATË QYTETARE	2+1	4
Edu 120	Z	EDUKIMI SHËNDETËSOR	2+1	4
Edu 121	Z	SHKATHTESIT E KOMUNIKIMIT ME FEMIJE	2+1	4
*Studenti zgjedh dy (dy) kurse zgjedhore nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				
Semestri IV				
Edu 122	O	LETËRSI PËR FËMIJË	3+2	6
Edu 123	O	MET. E MESIMIT TE MATEMATIKES I	3+2	7
Edu 124	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE II (5 JAVE)	2+2	6
Edu 125	O	HISTORI KOMBËTARE	3+2	6
Edu 126	Z	DRAMATIZIMI DHE SHFAQJET ME KUKULLA	2+1	5
Edu 127	Z	ARTET E BUKURA	2+1	5
Edu 128	Z	PSIKOLOGJIA ZHVILLIMORE	2+1	5
Edu 129	Z	STRATEGJITE DHE METODAT E SHKRIM LEXIMIT	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				

Viti i tretë - Programi Fillor				
Semestri V				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 130	O	METODOLOGJI E SHKENCAVE SHOQËRORE	Nr.	7
Edu 131	O	METODOLOGJI E ARTEVE FIGURATIVE	3+2	6
Edu 132	O	PRAKTIKA PED. III (6 JAVE)		6
Edu 133	O	BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE METODOLOGJI I	3+2	6
Edu 134	Z	SHKOLLA DHE KOMUNITETI	2+1	5
Edu 135	Z	ARSIMIMI GJATË GJITHË JETËS	2+1	5
Edu 136	Z	TENDENCAT BASHKËKOHORE NË ARSIM	2+1	5
Edu 137	Z	METODOLOGJI E LEXIMIT LETRAR	2+1	5
Edu 138	Z	STATISTIKE ELEMENTARE	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z)				
Semestri VI				
Edu 139	O	BAZAT E SHKENCAVE NATYRORE METODOLOGJI II	3+2	6
Edu 140	O	EDUKIMI GJITHPERFSHIRET ME METODOLOGJI	2+2	6
Edu 141	O	PSIKOLOGJI EDUKIMI	2+1	5
Edu 142	O	EDUKIMI MJEDISOR	2+1	5
Edu 143	Z	ZHVILLIMI I KURRIKULAVE	2+1	4
Edu 144	Z	VËSHTIRËSITË NE TË NXËNIT	2+1	4
Edu 145	Z	GJ. ANGLEZE PER MESUES	2+1	4
Edu 146	Z	ETIKA E MËSIMDHENIES	2+1	4
Edu 147	Z	EDUKIMI DHE MEDIAT	2+1	4
*Studenti zgjedh 2 (dy) kurse zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				

Viti i katërt - Programi Fillor				
Semestri VII				
Kursi	Statusi	Emri i kursit	Orët	ECTS
Edu 148	O	METODOLOGJI E MËSIMIT TË MATEMETIKES II	3+2	7
Edu 149	O	HISTORI E LETËRSISË KOMBËTARE	3+2	6
Edu 150	O	METODOLOGJI E EDUKIMIT FIZIK	3+2	6
Edu 151	O	METODOLOGJI E GJUHES SHQIPE	3+1	6
Edu 152	Z	ETNOLOGJI DHE LETËRSI POPULLORE	2+1	5
Edu 153	Z	VLERESIMI NE ARSIM	2+1	5
Edu 154	Z	PSIKOLOGJIA E PERSONALITETIT	2+1	5
Edu 155	Z	MENAXHIMI I KLASËS DHE DISCIPLINA	2+1	5
Edu 156	Z	FEMIJET DHE MESIMI NE NATYRE	2+1	5
*Studenti zgjedh një kurs zgjedhor nga lista e kurseve zgjedhore (Z).				
Semestri VIII				
Edu 157	O	BAZAT E HULUMTIMIT NË EDUKIM	2+1	6
Edu 158	O	PRAKTIKA PEDAGOGJIKE IV (8 JAVE)	/	14
Edu 159	O	PUNIMI I DIPLOMES	/	10

4.3. Gjuhë gjermane

Qëllimet e programit

Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane përgatit studentë për karrierë në dy fusha të ndryshme: Mësuesisë dhe të Përkthimit

Në dy vitet e para të programit, studentët do të ndjekin ligjëratat e njëjta të cilat kryesisht janë të fokusuara në aspektin hyrës të gjuhës, gjuhësisë, letërsisë dhe kulturës gjermane. Ndërsa në vitin e tretë dhe të katër, studentët kanë mundësinë të zgjedhin profilin për specializimet: Në Mësimdhënie apo Përkthim.

Specializimi në profilin e Mësuesisë

Studimet diplomike për specializimin në profilin e Mësuesisë për gjuhë gjermane ua mundëson studentëve ta organizojnë procesin e mësimit dhe mësimdhënies në gjuhën gjermane në grupe me studentë të moshave të ndryshme dhe tipe të klasave të ndryshme.

Komponenti themelor i programit universitar përbëhet nga ligjëratat profesionale duke përfshirë qasjet metodologjike dhe pedagogjike për mësimdhënie të gjuhës së huaj gjithashtu duke ngritur vetëdijen e studentëve të sistemit të Gjuhës Gjermane.

Specializimi në profilin e Mësuesisë ofron ligjëratat në metodologjinë e mësimdhënies së gjuhës dhe praktikën e organizimit të mësimdhënies në shkollat e zgjedhura. Programi ka për qëllim t'u ofrojë studentëve aftësi të duhura të gjuhës dhe t'u mundësojë atyre të komunikojnë në mënyrë efektive dhe funksionojnë në profesionin e tyre të zgjedhur; studentët për të hulumtuar dhe inkorporuar njohuritë e mjeteve dhe profesionalizmin organizativ të kërkuar për studimet e gjuhës dhe kulturës; frymëzon studentët të mendojnë në mënyrë kritike në traditën njerëzore lidhur me tekstet dhe gjuhën dhe mbrujtjen në student të ndryshmeve të natyrës pozitive të kulturës.

Specializimi në Përkthim

Qëllimi i drejtimit të përkthimit është që t'i arsimojë përkthyesit si ndërmjetës në mes të gjuhëve dhe kulturave. Ata do të jenë ekspertë në transmetimin e informatave dhe përmbajtjes nga një gjuhë në tjetrën, por gjithashtu edhe në formatin e tekstit.

Studentët do të mësojnë lidhur me teorinë dhe teknikat e përkthimit dhe interpretimit dhe do t'ju ofrohet përvojë kulturore e duhur dhe aftësi për karrierë në përkthim dhe interpretim të konferencave.

Brenda këtij programi studentët do të ndihmohen që të zbulojnë kapacitetet mësuese të gjuhës; ofron studentët me aftësi të duhura gjuhësore që t'ju mundësohet atyre komunikimi efektiv dhe funksional në profesionin e tyre të zgjedhur; për të hulumtuar dhe inkorporuar njohuritë e mjeteve dhe profesionalizmin organizativ të kërkuar për studimet e gjuhës dhe kulturës; frymëzon studentët të mendojnë në mënyrë kritike në traditën njerëzore lidhur me tekstet dhe gjuhën dhe mbrujtjen në student të ndryshimeve të natyrës pozitive të kulturës.

Objektivat e Mësimi

- Gjuha & Komunikimi, Të Shprehurit me Shkrim, Zhvillimi i Shkathtësive të avancuara në të shkruarit e gjermanishtes
- Gjuha & Komunikimi, Leximi i Gjithëmbarshtëm, Zhvillimi i shkathtësive të avancuara në të lexuarit e gjermanishtes
- Gjuha & Komunikimi, Dëgjimin e Gjithëmbarshtëm, Zhvillimi i shkathtësive të avancuara në të folurit e gjermanishtes
- Literaturë: T'i zhvillojë aftësitë e studentëve për ta përdorur terminologjinë e duhur gjuhësore, kulturore, apo analizat letrare.
- Linguistika: T'i zhvillojë aftësitë e studentëve që t'i njohin përbërësit e ndryshëm që e bëjnë gjuhën gjermane t'i kuptoj vetitë sintetike komplekse, dhe të analizoj dhe reflektoj ato në gramatikë.
- Njohuri kulturore; Zhvillon diturinë e studentëve të periudhave kryesore, zhanrin, autorët dhe lëvizjet e letërsisë gjermane brenda kontekstit të tyre kulturor, intelektual dhe socio-politik.
- Perspektivën globale dhe krahasuese: Të zhvillojë aftësinë e studentëve ta ndërlidhin civilizimin dhe shoqërinë e folësve të gjermanishtes me ngjarjet në vendet tjera përreth botës.

Hulumtimi i tregut

Studentët e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane, specializimin për shkollim e përfundojnë edukimin e tyre si individë me dituri efikase kulturore dhe sociale në fusha të ndryshme. Derisa një numër bukur i mirë i specializimeve të gjuhës gjermane do të zgjedhin të japin mësim-qoftë në nivelin e shkollës së mesme, apo pas diplomimit të duhur mund të punojnë në kolegji apo universitet. Theksimet në analizat tekstuale dhe aftësitë e të shkruarit do ta bëjë Gjuhën Gjermane specializim tradicional të fortë për shumë profesione, duke përfshirë gazetarinë, drejtësinë, shkrimin teknik, shkenca e bibliotekës, dhe llojllojshmërinë e fushave në biznesin botëror fusha në media dhe informim dhe turizëm gjithashtu në sa ma shumë institucione publike.

Ekzistojnë ofrues tjerë të Arsimit të Lartë në Kosovë të cilët ofrojnë program në Gjuhën dhe Letërsinë Gjermane. Megjithatë, programi i specializimit të arsimit të Gjuhës Gjermane Beçellor i ofruar në Universitetin e Prizrenit është përzjerje e ligjëratave të ndryshme që përgatit të diplomuar të duhur për Mësues qofshin ata në shkollat fillore apo të mesme. Është program më orientim tregu i cili ofron lëndë të rangut të gjerë për pajisjen e studentëve me shkathtësitë e nevojshme teorike dhe praktike.

Specializimi në Përkthim

Studentët të cilët do të specializohen për Përkthim e përfundojnë arsimimin e tyre si individ me dituri efikase kulturore dhe sociale në fushat e ndryshme.

Të diplomuarit mund të punojnë si administratorë, asistentë apo përkthyes dhe interpretues në kompani, redaktorë në shtëpi botuese, etj..

Me ngritjen e zhvillimit teknologjik dhe kërkesën e zhvillimeve të reja, gjithashtu kanë ngritur nevojën për qasje në literaturën e huaj ku përkthimi i kësaj bëhet i rëndësishëm për zhvillimet në shumicën e fushave në Kosovë.

Përveç kësaj, ata mund të punojnë gjithashtu në fushat e medie dhe komunikimit dhe turizmit gjithashtu në institucionet e ndryshme publike.

Që nga 1999 Kosova është karakterizuar me prezencë të bashkësisë ndërkombëtare. Si rezultat, janë shumë organizata ndërkombëtare të themeluara e që ende funksionojnë në Kosovë. Në këtë mënyrë nevoja dhe kërkesa për punësim të përkthyesve viteve të fundit është rritur tepër. Së pari, kjo kërkesë ka qenë më aktuale për organizatat ndërkombëtare dhe më pas fryma e rekrutimit të stafit të atillë u përhap edhe për institucionet publike kosovare të formuara rishtazi, gjithashtu institucionet tjera që janë në procesin e themelimit.

Partnerët

Specializimi në Mësuesi

Shumica e këtyre punëtorëve të diplomuar do të jenë të vendosur në shkollat e mesme në tërë Kosovën. Programi nuk e parasheh nënshkrimin e ndonjë dokumenti zyrtar, sipas nevojave të arsyetuara në përputhje me statistikat aktuale të zhvillimit në nivelin parauniversitar.

Puna praktike është e inkorporuar në program ku studentët gjatë vitit të tretë dhe katërt të studimeve do të kenë mundësi të krijojnë përvojën në punën e vërtetë. Kjo do të kualifikohet me kredi ECTS shtesë. Programi do të përgatisë studentët gjithashtu për kryerjen apo punën në sektorin privat në qendra të ndryshme të Gjuhës Gjermane dhe organizatave tjera që operojnë në Kosovë.

Specializimi në Përkthim

Duke konsideruar relevancën e lidhshmërisë së njohurisë së fituar gjatë studimeve me aspektin praktik, programi parasheh që puna praktike të inkorporohet në plan-programin mësimor të rregullt. Kjo mund të sqarohet më tutje që studentët në vitin e fundit të studimeve janë të obliguar ta bëjnë një periudhë mujore si praktikë nëpër institucione përkatëse apo ndërmarrje.

Për arsye praktike studentët mund të zgjedhin një kompani, organizatë apo institucion publik për kryerjen e punës praktike. Periudha e kryerjes së praktikës do të shkallëzohet me kredi ECTS.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Dizajnimi i programit të Gjuhës Gjermane, për të dyja profilet: të mësuesisë dhe të përkthimit është bazuar në modelin e Universitetit të Zagrebit, Fakulteti i Filozofisë, Departamenti i Gjuhës Gjermane, Universitetit të Shkodrës dhe universiteteve të tjera në rajon dhe vendet gjermanishtfolëse.

Niveli dhe modaliteti i bashkëpunimit me këto universitete do të konsolidohet në fazat vijuese.

Risite në këtë plan-program

- Praktikë gjuhe I - VI, me fond më të madh të orëve, për arsye që kemi studentë që fillojnë studimin me njohuri shumë të pakta, si dhe për mundësimin e perfeksionimit të gjuhës.
- Gjuha shqipe mbetet në fillim me dy semestra, pasi kemi studentë të gjeneratës së dytë të rritur në përfundim, që nuk kanë njohuri të gjuhës shqipe. Por edhe duke u nisur nga fakti që njohja e mirë e gjuhës së parë është ndihmesë për mësimin dhe zotërimin e gjuhës së huaj
- Gjuha e huaj është shtuar prej 2 në 3 semestra, pasi ka peshën e vet.
- Hyrje në shkencat e letërsisë në semestrin e parë, për të sqaruar nocionet bazë të kësaj shkençe
- Shtimi i fondit të lëndëve të letërsisë, pasi është studim i gjuhës dhe letërsisë gjermane
- Për ngritjen e cilësisë së studimit, në vitin III dhe IV, kemi paraparë mbajtjen e 3 seminareve (1 gjuhësi, 1 letërsi dhe 1 didaktikë e gjermanishtes si gjuhë e huaj)
- Kemi pasuruar listat e lëndëve zgjedhore

Pranimi i studentëve

Të përcaktohet nga menaxhmenti i programit të Universitetit

Kriteret për pranim

Të përcaktohet nga menxhmenti i programit të Universitetit

PLANPROGRAMI

Baçelor i arteve: Gjuhë dhe letërsi gjermane

Viti I - Semestri I dhe II viti akademik: 2012/2013 – I përgjithshëm

Nr.	Lënda	Statusi	ECTS	Orë
1.1	Praktikë gjuhe - I Gjuhë e sotme gjermane	O	8	90
1.2	Hyrje në gjuhë gjermane	O	4	30
1.3	Hyrje në linguistikë gjermane	O	4	30
1.4	Hyrje në letërsinë gjermane (në shkencën e letërsisë)	O	4	30
1.5	Civilizimi dhe kultura gjermane-I-	O	6	45
1.6	Gjuha shqipe -I-	O	4	30
2.1	Praktikë gjuhe II - Gjuhë e sotme gjermane	O	8	90
2.2	Gramatika e gjuhës gjermane -I- Fonetikë	O	6	45
2.3	Letërsia gjermane -I-	O	6	45
2.4	Civilizimi dhe kultura gjermane -II-	O	6	45
2.5	Gjuha shqipe -II-	O	2	30
2.6	Gjuhë e huaja (Gjuhë angleze apo gjuhë frënge) -I-	E	2	30
	Total ECTS		60	

Viti II - Semestri III dhe IV – I përgjithshëm

Nr.	Lënda	Statusi	ECTS	Orë
3.1	Praktikë gjuhe III - Gjuhë e sotme gjermane	O	9	90
3.2	Gramatika e gjuhës gjermane II -Morfologji I	O	6	45
3.3	Letërsia gjermane II	O	6	45
3.4	Hyrje në teknikën e punës së studimit të gjermanistikës	O	6	45
3.5	Gjuhë e huaj (Gjuhë angleze apo gjuhë frënge) II	O	3	30
4.1	Praktikë gjuhe IV - Gjuhë e sotme gjermane	O	9	90
4.2	Gramatika e gjuhës gjermane III -Morfologji II	O	6	45
4.3	Letërsia gjermane III	O	6	45
4.4	Shkrim kreativ	O	6	45
4.5	Gjuhë e huaj (Gjuhë angleze apo gjuhë frënge) III	E	3	30
	Total ECTS		60	

Viti III - Semestri V dhe VI – Profili: Mësuesi

Nr.	Lënda	Statusi	ECTS	Orë
5.1	Hyrje në didaktikë dhe metodologjinë e gjuhës gjermane - Procesi i adoptimit të gjermanishtes si gjuhë e dytë e huaj	O	7	45
5.2	Praktikë gjuhe V - Gjuhë e sotme gjermane	O	8	60
5.3	Gramatika e gjuhës gjermane IV - Sintaksë	O	6	45
5.4	Letërsia gjermane IV	O	6	45
5.5	Lëndë zgjedhore: ³	O	3	30
6.1	Hyrje në didaktikë dhe metodologjinë e gjuhës gjermane - Parimet themlore dhe metodat e mësimit të gjermanishtes si gjuhë e huaj	O	7	45
6.2	Praktikë gjuhe VI Gjuhë e sotme gjermane	O	8	60
6.3	Gramatika e gjuhës gjermane V - Leksikologji	O	6	45
6.4	Lëndë zgjedhore: Seminar në shkencën e letërsisë ⁴	O	6	45
6.5	Lëndë zgjedhore:	E	3	30
	Total ECTS		60	

Viti IV - Semestri VII dhe VIII– profili – Mësuesi

Nr.	Lënda	Statusi	ECTS	Orë
7.1	Metodat e aftësimit për mësimdhënie dhe njohurit e gjuhës gjermane (Fachdidaktik Deutsch)	O	8	45
7.2	Praktika profesionale në shkollë	O	6	
7.3	Lëndë zgjedhore: Seminar i gjuhësisë gjermane ⁵	E	8	60
7.4	Lëndë zgjedhore:	E	8	60
8.1	Praktika profesionale në shkollë	O	5	
8.2	Lëndë zgjedhore: Seminar i didaktikës ⁶	O	5	45
8.3	Diploma (teza)	O	20	
	Total ECTS		60	

Viti III - Semestri V dhe VI – Profili: Përkthimi

Nr.	Lënda	Statusi	ECTS	Orë
5.1	Teoria e përkthimit	O	5	30
5.2	Stilistika idiomatike dhe gjuha shqipe ika idiomatike dhe gjuha shqipe	O	5	45
5.3	Terminologjia dhe Profesionet e gjuhës I – Politikat dhe historia	O	6	45
5.4	Ushtrimi i shkrimit dhe përkthimit	O	3	45
5.5	Ushtrime praktike/ Internship I	O	5	
5.6	Lëndë zgjedhore	O	6	45
6.1	Metodologjia e Përkthimit	O	6	45
6.2	Përkthyesit dhe PC – Informatika për Përkthyes dhe Interpret	O	4	45
6.3	Institucionet e UE-së	O	4	30
6.4	Terminologjia dhe profesionet e gjuhës II – Politikat dhe Institucionet Qeverisëse	O	5	45
6.5	Ushtrime gjuhësore/ Internship II	O	5	
6.6	Lëndë zgjedhore	E	6	45
	Totali i ECTS		60	

Viti IV - Semestri VII dhe VIII- profili – Përkthimi

Nr.	Lënda	Statusi	ECTS	Orë
7.1	Leksiologji dhe Leksikografi	O	6	45
7.2	Gjuha mediale në vendet e të folmes së gjuhës gjermane	O	5	45
7.3	Terminologjia dhe profesionet e gjuhës III – Ekonomi, Ambient dhe Ligj.	O	6	45
7.4	Ushtrime Gjuhësore/ Praktikë profesionale III	O	5	
7.5	Lëndë zgjedhore	O	8	60
8.1	Historia e Artit dhe Kultures gjermane në vendet ku flitet gjuha Gjermane	O	5	45
8.2	Lëndë zgjedhore	E	5	30
8.3	Diploma (teza)		20	
	Totali i ECTS		60	

V. FAKULTETI I FILOLOGJISË

Drejtimit:

5.1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

5.2. Gjuhë dhe Letërsi Angleze

5.1. Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Arsyeshmëria e programit për tregun e punës

Programi në nivelin Baçelor (Bachelor) i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe në përgjithësi ka për qëllim aftësimin e studentëve për të ushtruar profesionin e tyre në të ardhmen. Me realitetin dhe mundësitë e reja të krijuar në Kosovë, Gjuha dhe letërsia shqipe ka qenë dhe është bërë e rëndësishme për ruajtjen, pasurimin apo zhvillimin e saj. Studimet në Programin Gjuhë dhe Letërsi Shqipe në nivelin Baçelor (Bachelor) zgjasin gjashtë semestra dhe brenda këtyre semestrave janë të harmonizuar dy fusha kryesore të studimeve (dhe nëndegët e tyre mbështetëse apo plotësuese): Gjuha dhe komunikimi, Letërsia dhe kultura. Këto fusha pastaj zbërthehen në lëndët e veçanta që i zhvillojnë dhe i thellojnë shkathtësitë gjuhësore të studentëve si dhe i zhvillojnë shkathtësitë e tyre akademike në mënyrë që të rrisin profesionalizmin në gjuhën dhe letërsi. Ata do të aftësohen për komunikim të rrjedhshëm në qarqet akademike dhe jo akademike dhe do të përgatiten për t'u përballuar me sfidat që mund t'i hasin në tregun e punës.

Krahasueshmëria ndërkombëtare e programit

Programi i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe është përshtatur dhe krahasuar me disa Programe të përafërta universitare, si me: Universitetin e Prishtinës, Tiranës, Korçës, Shkupit, Tetovës, Shkodrës, kurse përshtatshmëri dhe krahasueshmëri kemi bërë edhe më Universitetin e Vjenës, Universitetin e Munchinit, Universitetin e Ljubljanes, Universitetin e Budapestit etj.

Grupi target që i dedikohet programi

Nëpërmjet paraqitjes mjaft të pasur të këtij kursi (Programi), nga studentët promovohet të kuptuarit, studiuarit e gjuhës standarde dhe vlerësimit e trashëgimisë kulturore dhe të letërsisë shqiptare. Arritshmëria përfundimtar e studimeve deri në diplomim të këtij Programi të Gjuhë dhe Letërsisë Shqipe është përgatitja profesionale e kuadrove (mësimdhënës, lektorë, krijues, studiues...) dhe njëherazi do ta pranojnë dhe zotërojnë titullin Baçelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe.

Orientimi i drejtimeve të studimit sipas parimeve udhëheqëse të institucionit

Drejtimet e studimit, orientohen në parimet e realizimit të plan-programit, i cili mbështetet në udhëzimet e "Ligjit të Arsimit të Lartë" të Republikës së Kosovës; në udhëzimet ligjore dhe administrative të MASHT-it dhe kryesisht mbështetur edhe në Statutin e UPZ-së. Kështu që, duke i aplikuar standardet e nivelit më të lartë si dhe duke u bazuar gjithnjë në kërkesat e sistemit të Bolonjës dhe Lisbonës, ky Program do të jetë i kompletuar dhe premtues për t'u zgjeruar dhe garantuar cilësi.

Qëllimi dhe profili i programit të studimeve

Qëllimi përfundimtar i studimeve deri në diplomim të këtij Programit të Gjuhë dhe Letërsisë Shqipe është përgatitja profesionale e kuadrove (mësimdhënës, lektorë, krijues, studiues...) dhe njëherazi do ta pranojnë dhe zotërojnë titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe. Përveç aspektit pragmatik, studentët e këtij drejtimi do të pajisen edhe me njohuri të thelluara për nivele të ndryshme të sistemit gjuhësor përmes lëndëve: Hyrje në gjuhësi, Fonetikë e gjuhës shqipe, Leksikologji, Morfologji, Sintaksë, Dialektologji, Sociolinguistikë, Psikolinguistikë, Gjuhësi ballkanike, Metodologji e gjuhës amtare, Metodologji e punës shkencore, Gjuhësi indoeuropiane dhe gjenerative, Shkrim akademik.

Tërësia e studimeve të letërsisë ofrohet përmes lëndëve që paraqesin periudhat me të rëndësishme letrare: Hyrje në shkencën e letërsisë, Letërsi botërore, Etnofolklor, Letërsi shqipe (e vjetër, e Rilindjes dhe letërsi e viteve 1912 – 1939), Letërsi e krahasuar, Teori përkthimi, Letërsi e sotme shqipe (proza, poezia), Estetika.

Nëpërmjet paraqitjes mjaft të pasur të këtij kursi (Programi), nga studentët promovohet të kuptuarit, studiuarit e gjuhës standarde dhe vlerësimit e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Modulet e letërsisë ju lejojnë studentëve të zhvillojnë relacionin në mes të letërsisë dhe kulturës shqiptare, por edhe të atyre ballkanike, evropiane dhe botërore. Modulet plotësojnë njëra-tjetrën me një përzierje nxitëse dhe motivuese të gjuhës, letërsisë, kulturës dhe historisë së popullit shqiptar.

Lëndët zgjedhore në kuadër të Programit Gjuhë dhe Letërsi Shqipe synojnë të ofrojnë njohuri dhe shkathtësi shtesë për t'i zgjeruar spektrin e dijes së studentëve. Përmes atyre studentët do të pajisen me njohuri dhe shkathtësi në fusha me të ngushta profesionale sipas nevojave dhe afiniteteve të tyre, siç janë: Përdorimi i gjuhës standarde, komunikim i rrjedhshëm, njohuri për gjuhësinë shqiptare, ballkanike dhe evropiane, metodologjie dhe shkathtësi e punës hulumtuese dhe shkencore, krijimtari kreative, njohuri për letërsinë shqiptare, ballkanike dhe botërore.

Rezultatet e pritura të mësimt

Pas përfundimit të suksesshëm të këtij programi, studentët do të jenë në gjendje:

- të komunikojnë, shkruajnë, hulumtojnë dhe të krijojnë rrjedhshëm dhe me përpikëri në nivel të lartë akademik.
- të dëshmojnë njohuri të nivelit të lartë të sistemit gjuhësor dhe letrar.
- të dëshmojnë nivel të lartë të njohurive për ngjashmëritë dhe dallimet kulturore që kanë të bëjnë me gjuhën, kulturën dhe letërsinë shqipe dhe të ndërmjetësojnë për lehtësimin e komunikimit ndërkulturor.

Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike/eksperimentale të studimit;

Në mënyrë që të jenë sa më të përgatitur, të hapur dhe të ballafaqohen me kërkesat bashkëkohore, ky program ju ofron studentëve modulet të gjuhës (greke dhe latine) angleze, gjermane dhe frënge me qëllim të zgjerimit të njohurive të tyre gjuhësore, dhe zotësinë e tyre për t'u bërë konkurrent në tregun e punës. Në këtë rregullore janë pasqyruar veprimtaritë mësimore të organizuara në module dhe të vlerësuara me kredite, që do të zhvillohen në një periudhë 3- vjeçare. Në këtë program studimi të ciklit të parë janë parashikuar 43 provime e forma të tjera vlerësimi përfundimtar të dijeve, që do të realizohen nëpërmjet provimeve të integruara për më shumë se një disiplinë apo module të koordinuara. Në këto raste, lektorët dhe titullarët e disiplinave bëjnë vlerësim kolegjal të studentëve.

Llogaritja e ECTS-ve

Në planin mësimor të programit të studimit, disiplinat mësimore janë renditur dhe të grupuara sipas natyrës së veprimtarive formuese dhe konkretisht janë; disiplina të formimit të përgjithshëm me 448 orë në auditor dhe 36 kredite; disiplina të formimit karakterizues që kanë 965 orë në auditor dhe 82 kredite; disiplina formuese, të ngjashme, integruese 270 orë dhe 24 kredite; gjuha e huaj, informatika, praktika, stazh 280 orë 20 kredite; disiplina të zgjedhura nga studentët 198 orë me 13 kredite dhe përgatitje për tezën e diplomës 5 kredite. Në çdo plan-program janë vendosur qëllimet, objektivat, përmbajtja dhe literatura. Këto plan-programe do të përsosen dhe pasurohen në mënyrë të vazhdueshme me të rejtat bashkëkohore në këto shkencë. Synimet që duhet të arrihen përmes këtij programi studimi është që studentët në fund të këtij programi të kenë njohuri të konsiderueshme në fushën e gjuhësisë shqipe dhe letërsisë vendase dhe asaj të huaj.

Studentët që diplomojnë u mundësohet në këtë drejtim vazhdimin e ngritjes akademike dhe profesionale dhe të drejtën e regjistrimit në studimet e nivelit Master.

Puna praktike – internshipi

Universiteti ynë ka marrëveshje me të gjitha shkollat parauniversitare, e cila siguron se studentët mund të shkojnë në të gjitha shkollat publike për ta kryer praktikën. Puna praktike për Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe është e rëndësishme dhe e domosdoshme, sepse fillimisht përgatitja e tyre është arsimore dhe me vonë edhe shkencore.

Pasqyrë e programit

Viti I Semestri I			
